




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 01.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 30.05.2023 dhe 31.05.2023 të parashtruar nga: N.SH. TEST&ING si dhe " IPE CONTROLS - ING " SH.P.K. *lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike "*, *me nr.identifikues 651-23-3501-2-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 036 221 nxjerr:*

### V E N D I M

**Refuzohen** – kërkesat për ri-shqyrtim të " N.SH. TEST&ING si dhe " IPE CONTROLS - ING " SH.P.K. "*lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike "*, *me nr.identifikues 651-23-3501-2-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 036 221 të datës 30.05.2023 dhe 31.05.2023 kundër Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde - të datës 26.05.2023 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.*

1. AK - Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde të datës 26.05.2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### A r s y e t i m

N.SH. TEST&ING si dhe " IPE CONTROLS - ING " SH.P.K. me datë 30.05.2023 dhe 31.05.2023, kanë parashtruar kërkesat e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekzaminimi I material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike " *me nr.identifikues 651-23-3501-2-2-1 dhe*

**numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 036 221.** Autoriteti Kontraktues me datë **01.06.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga **N.SH. TEST&ING** si dhe "**IPE CONTROLS - ING**" SH.P.K. ,Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara në lidhje me pretendimet e juaja :

**Pretendimi ankimor i parë :**

*OE IPE-PROING SH.P.K i rekomanduar me dhënien e kontratës nuk i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në këtë kuptim tenderi i tij nuk është në pajtueshmëri me kriteret e nenit 59.4 lidhur me nenin 60 par.11. të LPP-së, plotësuar me dispozitat e legjislacionit sekondar të nenit 40 paragrafi 1 dhe 6 pika b) e Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022. Më konkretisht tenderi i OE të rekomanduar me dhënie të kontratës nuk e përmbush plotësisht kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare që janë vendosur në nenin 8.1&8.2 të FTD-së, Kërkesa 1 ku parashikohet se: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 60,000.00 euro. Dëshmia e kërkuar dokumentare – Dëshmia 1: "Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen me sukses të punëve"*

*Objekti i shërbimit që është prokuruar përmes këtij aktiviteti në të gjitha zërat e dosjes së tenderit që janë përfshirë në Aneksin 1 (specifikimet teknike të detyrueshme) dhe në përkufizimin e paramasës kanë të bëjnë me kategoritë e mëposhtme të shërbimeve: ekzaminimi i betonit, ekzaminimi i pllakave nga guri natyral, ekzaminimi i asfaltit, ekzaminimi gjeomekanike.*

*Nga OE i rekomanduar me dhënien e kontratës për t'a plotësuar kriterin mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nga neni 8.1&8.2 të FTD-së, kërkesa 1, si dëshmi është paraqitur edhe kontrata e lidhur me datën 03.01.2020 me kontraktorin OCTACOM Sh.p.k. që është ekzekutuar nga kompania IPE PROING. Objekti i punëve të realizuara sipas kësaj kontrate ka të bëjë me mbikqyrje të punimeve në ndërtimin e objektit Prishtina Mall. Sipas përmbajtjes dhe përkufizimit të objektit të kësaj kontrate, rezulton me faktin se llojet e punimeve të përfshira në këtë kontratë nuk ndërlidhen dhe nuk përkojnë me zërat e kërkuar në dosjen e tenderit që parashikojnë llojet e punimeve të ekzaminimeve në kategoritë e lartshënuara. Kontrata në fjalë as nga titulli e as nga përmbajtja nuk ka asnjë pozicion që përfshihen dhe parashikohen punimet në ekzaminime.*

*Në këtë kuptim dëshmia e cila i referohet kësaj kontrate që është emërtuar "Certifikatë e pranimit final të shërbimeve" e lëshuar nga PRO ING Sh.p.k për klientin OCTACOM nuk përputhet me objektin e shërbimeve në kontratën e lartshënuar sepse objekti i kontratës në fjalë duke filluar nga titulli dhe përmbajtja e saj si object të punimeve ka punët e shërbimeve të mbikqyrjes dhe menaxhimit. Pastaj, duke u bazuar edhe në përshkrimin e faturës F20-01-31 shprehimisht përshkrimi përkufizohet e punët janë kryer në ofrimin e shërbimeve për mbikqyrjen e punimeve në ndërtimin e objektit të qendrës tregtare Prishtina Mall. Për me tepër ju sqarojmë se të gjitha faturat tjera janë me përshkrim të njejtë, që nënkupton se parashikojnë, janë lëshuar për ofrimin e shërbimeve për mbikqyrjen e punimeve në ndërtimin e objektit.*

**Pretendimi ankimor i dytë :**

Komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, në kundërshtim me Nenin 61 të LPP-së, dhe Rregullores nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, nuk ka vepruar sikurse ka qenë i obliguar për tenderin që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët.

Koncepti i tenderit jo-normalisht i ulët i referohet tenderëve që për AK në shikim të parë duket si jo i besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat që ka gjasa për një ndikim negativ në implementimin e kontratës. Në rastin tonë, në këtë aktivitet prokurimi, konform Rregullores nr.001/2022 Për Prokurimin Publik janë përmbushur të gjitha kushtet për një tender jo-normalisht të ulët, citoj:

“41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Sipas këtij pretendimi AK kundërligjshëm ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat procedurale të LPP-së, pa kërkuar sqarime dhe është rekomanduar për kontratë një OE me çmim jo-normalisht të ulët.

**Pretendimi ankimor i tretë :**

Sipas kërkesës në FDT të dosjes së tenderit: “Një (1) inxhinier I diplomuar i gjeodezisë ose master i diplomuar me me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i gjeodezisë me me se paku tre vite përvojë pune pas diplomimit ; Dëshmia 2 CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.” OE tenderues ka ofruar Kontratë Pune e jo Marrëveshje mbi angazhimin në këtë projekt Ing. Hekuran Demiri me numër ID 1173086608. Pas kërimit në sistemin e ATK-së linku: <https://apps.atk-ks.org/regemployer> rezulton se punëtori i njëjtë ka punuar në këtë kompani deri në Janar 2023. Sipas këtij pretendimi Komisioni Vlerësues i AK me një kërkim të thjeshtë në sistemin e ATK-së ka mundur ta verifikojë se punëtori në fjalë a është i lajmëruar si punëtor i rregullt në ATK nga OE dhe kurse ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe në kundërshtim Deklaratën Nën Betim të ofruar nga vetë OE.

Andaj, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

**Përgjigje rreth pretendimeve ankimore :**

Tek Kapaciteti teknik dhe professional:

*Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 60.000,00 euro.*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*Dëshmia 1 Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje me sukses të punëve.*

*AK – Autoriteti Kontraktues, më saktësisht Komisioni Profesional për Ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave : ka konstatuar se sa i përket kontratës së OE lidhur me punën e përfunduar në Prishtina Mall Përbushë vlerën e specifikuar në DT si dhe në Njoftimi për Kontratë ku dhe te kjo e fundit kërkohen “ ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme “ dhe për atë arsye kjo kontratë është llogaritur si valide.*

*Ndërsa sa i përket :*

*Një (1) inxhinier I diplomuar i gjeodezisë ose master i diplomuar me me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i gjeodezisë me me se paku tre vite përvojë pune pas diplomimit ;*

*Si dhe dëshmia : CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.*

*Që do të thotë se: ne si AK – Autoritet Kontraktues nuk është kërkuar Lista e ATK, Referencë apo diçka e tillë. Andaj, ne i përmbahemi kushteve që janë të specifikuara në DT dhe që rezultojnë kjo që e potencojmë.*

*OE i rekomanduar për kontratë, në ofertën e tij ka të ngritur si Gjeodet Ing. Hekuran Demiri dhe ka të lidhur Kontratë pune me “ kohë të pacaktuar “ ku ka të bashkëngjitur Diplomën, Licencën, CV ashtu siç është kërkuar në DT që do të thotë se : çdo kriter që nuk figuron në DT si dhe Njoftimin për Kontratë ne si AK – Autoritet Kontraktues nuk kemi të drejtë ta rishqyrtojmë sipas LPP-së dhe RROUPP-së.*

***Rrjedhimisht, AK – Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde të datës 26.05.2023***


Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Shqipe Hoxha**

  
Menaxhere e zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës.